



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02/07/22

Datë: 24. 10. 2022, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Shtatë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 24 Tetor 2022, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV),
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Mbledhjen e Shtatë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znjsh. Zejnepe Gaxherri, ndërsa prezantoj dhe kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit,
2. Siguria e nxënësve në shkollën fillore dhe të mesme në Komunën e Junikut,
3. Shqyrtimi i prishjes së varrezave në fshatin Gjocaj, dhe
4. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u shqyrtua dhe u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe u miratua nga të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës **Siguria e nxënësve në shkollën fillore dhe të mesme në Komunën e Junikut**

Për raportim rreth kësaj pike të Rendit të Ditës mungoj zyrtari nga Drejtoria e Arsimit, ndërsa fjalën e mori znj. Safete Shehu e cila kërkoj që shkollat dhe vendet ku frekuentojnë nxënësit të pajisen me kamera të sigurisë.

Z. Zenel Maloku, prapë kërkoj lirim të trotuareve nga makinat të cilat rrezikojnë nxënësit dhe qytetarët, ndërsa tha se fajtorë për këtë janë; Kryetari i Komunës, Drejtori i Arsimit, Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Policia e Junikut, të cilët nuk i kryejnë punët e tyre ashtu siç duhet.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës **Shqyrtimi i prishjes së varrezave në fshatin Gjocaj**

Fjalën e kërkoj z. Zenel Maloku i cili tha, në fshatin Gjocaj janë prishur rreth 50 varreza në pronën publike nga Drejtori i Shërbimeve Publike dhe babai i tij, dhe kjo me dijeninë e Komunës së Junikut.

Z. Valdrin Isufaj kërkoj të di qëllimin dhe arsyejen e prishjes së këtyre varrezave?

Z. Zenel Maloku tha, arsyetimi ka qenë se aty ka pasur vetëm dy apo tri varreza, mirëpo në bazë të dëshmive të bashkëfsharëve aty kanë qenë rreth 50 deri në 60 varreza. Pra, është prishur prona publike, janë prishur varrezat e fshatit.

Ky akt duhet të dënohet nga Kuvendi dhe Komuna. Edhe policia ka dështuar në parandalimin e kësaj pune, ndërsa arsyen në nuk e dimë, këtë e dinë vet Drejtori i Shërbimeve Publike.

Me këtë çështje duhet të merret Gjykata dhe Prokuroria e Shtetit. Këtë çështje ne duhet ta shtjellojmë në mbledhjen e radhës së Kuvendit, por unë pata dëshirë ta cekë edhe këtu, pra në Komitet për Komunitete.

Pika e Katërt e Rendit të Ditës **Të ndryshme**

Znj. Safete Shehu ngriti çështjen e mbeturinave në Komunën e Junikut, ndërsa tha se që tri jave nuk është bërë mbledhja e mbeturinave, ndërsa nga puna janë larguar edhe pesë punëtorë të higjienës, dhe kjo është për keqardhje.

Znj. Safete Shehu kërkoj që të gjendet një zgjidhje dhe të rregullohet çështja e mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave në Komunën e Junikut. Me këtë u pajtuan të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Në vazhdim znj. Safete Shehu tha, unë nuk pajtohem që një kompani jashtë Junikut të kontraktohet për mbledhjen e mbeturinave, dhe ne si komitet dhe shoqëri civile këtë duhet ta kundërshtojmë vazhdimisht.

Z. Zenel Maloku po ashtu theksoj se nuk është në rregull që të hiqen nga puna punëtorët e Junikut dhe në vend të tyre të punësohen të tjetër jashtë Junikut.

Z. Valdrin Isufaj tha se kompania ‘V.B. Tofaj’ për gjashtë muaj ka qenë jashtë kontratës, mirëpo ata kanë kërkuar vazhdimin e kontratës në mandatin e Kryetarit të mëparshëm, mirëpo kjo kontratë nuk u është vazhduar, ndërsa Kryetari i tanishëm ka kundërshtuar pagesën shtesë rreth 10,000.00 E, për të cilën shumë thotë se e paguajnë qytetarët. Ndërsa, kompania nuk ka mundur të punoj pa përfitim dhe është tërhequr nga kontrata, por ka kërkuar që punëtorët e higjienës të mbahen në punë dhe ka ofruar kamionin e saj për mbartjen e mbeturinave, por sido që të jetë, ne kërkojmë zgjidhje lidhur me këtë çështje.

Z. Zenel Maloku ceku edhe sjelljen e mbeturinave, siç janë; sfungjerë dhe materiale të tjera nga kompania “Comodita Home” në deponinë e mbeturinave në Junik. Djegia e tyre paraqet rrezik për qytetarët dhe ambientin e Komunës së Junikut dhe me gjerë. Unë kërkoj hetim dhe ndëshkim nga Komuna dhe organet kompetente rreth kësaj çështje.

Z. Zenel Maloku tha, tjetër çështje është edhe vjedhja e 300 m kubë dru nga traseja e rrugës, të cilat janë shpërndarë në vende të caktuara muajin e kaluar. Unë nuk e di se si mund të arsyetohet kjo nga Kryetari i Komunës dhe Policia e Junikut.

Znjsh. Eliza Pepshi ngriti edhe çështjen e qeneve endacakë, dhe kërkoj që të merren masa mbrojtëse nga qenet endacakë në Komunën e Junikut.

Me kaq, kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Gëzim Geci

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Zejnepe Gaxherri